



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE



BORDI I KOMISIONEREVE

**VENDIM**

**Nr .41 Date 11. 04. 2008**

**PER**

**PEZULLIMIN E SHQYRTIMIT TE APLIKIMEVE PER LICENSIM NE  
AKTIVITETET E NDERTIMIT DHE PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE  
NGA BURIMET E RINOVUESHME QE NUK TRAJTOHEN SIPAS LIGJIT PER  
KONCESIONET**

Ne mbeshtetje te nenit 9, te Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” te ndryshuar, Bordi i Komisionereve te ERE-s, ne mbledhjen e tij te dates 11.04.2008, pasi diskutoi mbi problematiken e ngritur nga OST sh.a ne lidhje me limitin qe duhet vene per fuqine e pergjithshme qe mund te instalohet ne sistemin elektorenergjistik nga centralet eolike ne vendin tone, si dhe ne kuader te ngritjes se nje grupi pune nderministror per kryerjen e nje studimi per kete qellim,

**VENDOSI:**

1. Pezullimin e shqyrtimit te aplikimeve per licensim ne aktivitetet e ndertimit dhe prodhimit te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme qe nuk trajtohen sipas Ligjit nr. 9663, date 18.12.2006 “Per konçesionet” deri ne daljen e konkluzioneve perfundimtare te grupit te punes mbi kete çeshtje.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje per kete vendim, te gjitha subjektet qe kane paraqitur aplikime per licensim ne aktivitetin e ndertimit dhe prodhimit te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme qe nuk trajtohen sipas Ligjit nr. 9663, date 18.12.2006 “Per konçesionet”.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**

**Bujar Nepravishta**